



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 7100/2 prot.

Himarë, më 12.12.2024

NJOFTIM PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PRANIMIT TË KËRKESAVE NË KUADËR TË PROCESIT TË RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË HIMARË

Në mbështetje të ligjit nr. 41/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, V.K.M-se nr.377, datë 12.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar; Vendim nr. 694, datë 2.10.2019 "për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.686, datë 22.11.2017, të Këshillit të ministrave, "për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar;

Referuar fluksit masiv të interesit të komunitetit për përfshirje të kërkesave në këtë procedurë dhe përpunimit të tyre sipas kartelave përkatëse;

Ju njoftojmë se afati i përfundimit të pranimit të kërkesave për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Himarë, (miratuar me Vendim të K.K.T –së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar me vendim nr.5 datë 10.06.2020, Vendim nr.5 të K.K.T–se date 15.04.2021, vendim nr.2 të K.K.T-se nr.2 date 25.04.2023), do të shtyhet deri me datën **17.01.2025**.

Ju faleminderit,

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVËNDËSKRYETARI

Pervin Gjokuria

